

RELACIONI ARKITEKTONIK

OBJEKTI : “ HARTIM PROJEKTI PER RIKONSTRUKSIONIN E GODINES SE POLIKLINIKES QENDRORE KRYESORE DURRES ”



Projektues: ARKONSTUDIO SH.P.K.



Porosites: Spitali Rajonal Durrës

INFORMACIONE DHE TE DHENA PER PROJEKTIN

- **Objektivi kryesor i projektit eshte :**

Rikonstruksioni i plete sipas te gjitha standarteve te percaktuar nga Legjislacioni ne fuqi per Godinat Sociale e Shendetesore duke nderhyre rrenjesisht ne te gjithe elementet perberes te saj, me qellim funksionimin komod te aktiviteteve shendetesore qe zhvillohen ne kete objekt.

- **Qellimi**

Qellimi kryesor i kesaj kontrate eshte hartimi i Projekt-Preventivit te Zbatimit te plete per Rikonstrukcionin e Godines ekzistuese te Poliklinike Qendrore Durrës.

Realizimi i ketij projekt zbatimi i cili do te permiresoje dhe do te shtoje ne menyre cilesore kushtet e ketij objekti si dhe do te krijoj mundesine e aksesimit nga ana e personave me aftesi te kufizuara.

Sipas Termave te References, gjithashtu dote behet dhe permbushja e pikave te me poshteme :

- Te rigjeneroje godinen si nga ana fizike (Suvatimet e mureve shtesat e pllakave e tavanet me gjithe sistemin elektrik e hidraulik) ashtu edhe nga ana arkitektonike.
- Te ofroje kushte me te mira per banoret e Qarkut si dhe per stafin mjekosor.
- Te ofroje nje sherbim sa me cilesor per te gjithe qytetaret qe kane nevoje per sherbime.

- **Historiku dhe situata ekzistuese**

Poliklinika Qendrore eshte një Institucion Shendetesor ku kryhen vizita mjekesore te speciliteteve te ndryshme nga te gjithe banoret e Qarkut te Durrësit jo vetem me rekomandimet e Mjekut te familjes por edhe me tej. Vendndodhja e godines eshte ne Rrugen "Fetah Bllaca", Lagja nr.4.

Gjithashtu ne kete Qender kryhen edhe nje sere analizash. Objekti eshte nje Godine 3 kate mbitoke + 1 kate Podrum e ndertuar ne vitin 1957 dhe ne vitet 1995 e 1996 i jane bere punime te pjeseshme dhe ne vitin 2016 me te ardhurat dytesore u krye hidroizolimi me dy duar katrama i taraces .

Pershkrim: Godina eshte 3 kate mbitoke ($647 \text{ m}^2 \times 3 \text{ kate} = 1.941 \text{ m}^2$) dhe nje kate podrum me $\frac{1}{2}$ nentoke (rreth 191 m^2). Poliklinika eshte një Institucion Shendetesor ku kryhen vizita mjekesore te speciliteteve te ndryshme nga te gjithe banoret e Qarkut te Durrësit. Gjithashtu ne kete Qender kryhen edhe nje sere analizash. Godina e Poliklinikes Qendrore eshte i vetmi objekt i ketij lloji (Qender Shendetesore per vizita te specializuar) ne qytetin e Durrësit.

- **Kerkesa te pergjithshme**

Projekti i rikonstruksionit te ndertesës se Poliklinikes do të realizoje ruajtjen dhe evidentimin e vlerave arkitektonike, urbanistike e mjedisore të qytetit të Durrësit si dhe synon të kthehet në një godinë me kushtë bashkekohore dhe standarde nderkombetare.

Projekti i rikonstruksionit do të hartohet duke pasur objektiv kryesor standartet kombetare dhe nderkombetare të projektimit për këtë tipologji ndertese si dhe të plotesoje kushtet e komfortit termik. Lageshtia, fluksi i drites dhe ajrim/kondicionimi do të plotesojnë parametrat evropiane për këtë objekt të rendesishë se veçante. Gjithashtu, një element i rendesishëm i projektimit është sigurimi i levizjes se PAK (personave me aftesi të kufizuar) dhe sinjalistika për to.

- **POZICIONIMI I OBJEKTIT**

Objekti pozicionohet në Durrës kufizohet në pjesën veriore me rrugen Nazmije Vigani. Ka një distancë rreth 500 m nga qendra e Durrësit.



▪ FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE TE PRONES





- Objekti


Planimetria e Katit perdhe

Ne planin e katit perdhe eshte shtuar nje strehe perballle hyrjes, nje rampe per personat me aftesi te kufizuara me pjerresi 6%. Gjithashtu edhte krijuar nje holl dhe recepcioni dhe nje salle pritej.

Gjithashtu eshte vendosur nje ashensor, shkalla eshte kthyer ne shkalle antizjarr.


Ne anen e majte te objektit kemi radiologjine, sallen e komandit dhe zyren e mjekut radiolog.

Perballle radiologjise kemi sallen e DEXA me sip 14 m².




Planimetria e katit te pare

Ne planin e katit te pare pozicionohen dhomat e mjekeve , tualetet e stafit dhe tualetet per paciente.




Planimetria e katit te dyte

Ne planin e katit te pare pozicionohen dhomat e mjekeve, tualetet e stafit dhe tualetet per paciente dhe salla e mbledhjeve ne ane te djathte te objektit.



Planimetria e podrumit

Ne planin e katit te podrumit kemi hapesirat per depozitat e ujit.




• Fasada Jugore

Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm + rrjete + suva grafiato

Fasada Jugore e projektit trajtohet me një veshje perimetrale me alukobond dhe me hijezues alumini

FASADA JUGORE



• Fasada Veriore

FASADA VEROIRE



- Fasada Lindore

FASADA LINDORE



- Fasada Perendimore

FASADA PERENDIMORE









